

	REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVA KOMUNA E RAHOVECIT OPSTINA ORAHOVAC MUNICIPALITY OF RAHOVEC	
---	--	---

Për:	Grup i Operatorëve Ekonomik: LINDI MARKINGS SH.P.K.; BENI - COM SH.P.K., Vitomeric Rejoni 3, 30 000, Pejë Operatorëve Ekonomik Të gjitha palëve të interesuar
Nga:	Astrit Mullabazi, Menaxher i Zyrës së Prokurimit
Lënda:	VENDIM për Rishqyrtim të Kërkesës
Datë:	18.05.2022

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Rahovecit, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.1) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas **Kërkesës për Rishqyrtim** të datës: **16.05.2022**, të parashtruar nga Grup i Operatorëve Ekonomik: **LINDI MARKINGS SH.P.K.; BENI - COM SH.P.K.** me adresë në **Pejë**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **SINJALIZIMI HORIZONTAL DHE VERTIKAL I RRUGËVE**, me Numër të prokurimit: **623-22-1304-5-2-1**, Numër i brendshëm: **623-22-001-5-2-1**, nxjerr:

VENDIM

- I. **REFUZOHET** si e pa bazuar kërkesa e parashtruar nga Grup i Operatorëve Ekonomik: **LINDI MARKINGS SH.P.K.; BENI - COM SH.P.K.** me adresë në **Pejë**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **SINJALIZIMI HORIZONTAL DHE VERTIKAL I RRUGËVE**, me Numër të prokurimit: **623-22-1304-5-2-1**, Numër i brendshëm: **623-22-001-5-2-1**, kundër Njoftimit mbi vendimin e AK – së, të datës: **11.05.2022**, të publikuar në ueb – faqe: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- II. Autoriteti Kontraktues vendos të vazhdoj me Njoftim Mbi Vendimin e Autoritet Kontraktues për aktivitetin e prokurimit: **SINJALIZIMI HORIZONTAL DHE VERTIKAL I RRUGËVE**, me Numër të prokurimit: **623-22-1304-5-2-1**, Numër i brendshëm: **623-22-001-5-2-1**.
- III. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronik në adresën: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

A R S Y E T I M

Grup i Operatorëve Ekonomik: **LINDI MARKINGS SH.P.K.; BENI - COM SH.P.K.** me adresë në **Pejë**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **SINJALIZIMI HORIZONTAL DHE VERTIKAL I RRUGËVE**, me Numër të prokurimit: **623-22-1304-5-2-1**, Numër i brendshëm: **623-22-001-5-2-1**, kundër Njoftimit mbi vendimin e AK – së, të datës: **11.05.2022**, të publikuar në ueb – faqe: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>, ka bërë Kërkesë për Rishqyrtim me datë: **16.05.2022**, sipas nenit 108/A, të Ligjit për Prokurimin Publik (LPP) me Nr. 04/L-042.

BAZA LIGJORE PËR REFUZIM TË KËRKESËS

PRETENDIMI ANKIMOR Nr. 1:

Ju sqarojmë se arsyet tuaja për eliminimin tonë janë të paqëndrueshme për faktet si më poshtë:

Sa i përket arsyes tuaj të parë për eliminimin tonë, ku e keni cekur se kinse nuk kemi ofruar kontrata në vlerën e kërkuar prej 225,000.00€, ju sqarojmë se ky arsyetim i juaji është i pabazuar dhe nuk qëndron për faktin se ne jo vetëm që e plotësojmë vlerën minimale të kontratave të kërkuara, mirëpo edhe e tejkalojmë atë.

Nëse analizohen kontratat e prezantuara nga ana jonë shihet qartë se arsyeja juaj është e paqëndrueshme. Ju si AK siç duket i keni marr parasysh vetëm kontratat e vitit 2020 dhe 2021, duke mos i analizuar në tërësi të gjitha kontratat e prezantuara nga ana jonë, mirëpo i keni

Ne po e përmendim vetëm njëri nga kontratat e prezantuara nga ana jonë me anë të së cilës e tejkalojmë vlerën minimale të kërkuar nga ana juaj. Nëse analizohet kontrata me KK Obiliq, shihet qartë se njëjta është e lidhur me dt.06.06.2018 dhe e njëjta mbaron pas një viti pra me 06.06.2019, në të njëjtën kontratë ne kemi përfunduar edhe punë shtesë vlere e të cilave është 4,830.40 €, fakt ky që tregon qartë se arsyeja juaj e lartcekur për eliminimin tonë është e paqëndrueshme dhe njëkohësisht e pa mbështetur në dispozita ligjore.

Ju si AK është dashur ti analizoni në tërësi kontratat e prezantuara nga ana jonë dhe pastaj të bëni vlerësimin e tyre konform dispozitave ligjore, sepse nuk mund dhe nuk duhet të merret parasysh vetëm data e nënshkrimit të kontratës, mirëpo data e përfundimit të saj, andaj konform këtyre fakteve kuptohet qartë se ne si OE e përmbushim kërkesën e dosjes së tenderit dhe të njoftimit për kontratë në lidhje me kontratat e përfunduara në tri vitet e fundit.

PËRGJIGJE PËR PRETENDIMI ANKIMOR Nr. 1:


Ju sqarojmë se ky pretendim i juaj është i pabazuar, pasi që ju keni ofruar listën e punëve të kryera në të cilën keni theksuar se posedoni gjithsej tetë (8) kontrata dhe nga to janë vetëm tri (3) kontrata ne periudhën e shkuar tre (3) vjeçare para njoftimit për kontratë. Vlora e këtyre tri (3) kontratave është: **223,238.62 €** (dyqind e njëzet e tremijë e dyqind e tridhjetë e tetë euro e gjashtëdhjet e dy cent) pra me listën e paraqitur ju nuk keni arritur të dëshmoni që e plotësoni kriterin : *Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale*

Kërkesa 3 Operatori Ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata të natyrës së ngjashme (furnizim me shenja, sinjalistike dhe të ngjashme me natyrën e projektit), në tri vitet e fundit nga data e publikimit të Njoftimit për Kontratë, në vlerë min. 225,000.00 Euro

Dëshmia 3 Lista e projekteve të kryera në lëmin e punëve të ngjashme (furnizim me shenja, sinjalistike dhe të ngjashme me natyrën e projektit), të realizuar në tri vitet e fundit, nga data e publikimit të Njoftimit për Kontratë, duke saktësuar Titujt e projekteve, shumën e kontratës, numrin e Prokurimit, data e kontraktimit – duhet dorëzohet në original, i nënshkruar dhe i vulosur nga Operatori Ekonomik, DHE dëshmitë e përfundimit, Referenca t ose Pranimit teknik.

Dëshmia: Lista e Kontratave


04.02.2022



LISTA E KONTRATAVE TË REALIZUARA
2018-2019-2020-2021 nga Lindi Markings sh.p.k Aneksi 2

NR.	Titulli i kontratës	Data e nënshkrimit të kontratës	Data e përfundimit të kontratës	Vlera totale e kontratës	Emri i Blerësit	E-maili i Blerësit	Nurmi i telefonit të Blerësit
1	Mëmbajtja e Adresave në Serotin e Komunës së Istogut me nr. Prok. 633-17-1680-2-2-1 FA024	24.05.2018	01.11.2018	11 400.00	K.K.Istog	istog@ksh.gov.net	0302043018
2	Vendosja e tabelave informuese dhe edukative rrethorë në shkollë	20.04.2018	21.05.2018	5 096.20	K.K.Obiliq	prokurim@ksh.gov.net	0302041301
3	Sinjalizim Horizontal dhe Vertikal në rrugët e Komunës së Pejë me nr. Prok.635/18/533/221	11.04.2018	07.08.2018	17 120.00	K.K.Pejë	prokurim@ksh.gov.net	0302043436
4	Sinjalizim Horizontal dhe Vertikal në rrugët e Komunës së Pejë me nr. Prok. 06614-16-2454-1-2-1	06.06.2018	27.07.2018 Pun shtes---	22 546.00 4 830.40	K.K.Obiliq	prokurim@ksh.gov.net	0302041301
5	Sinjalizim Vertikal dhe Horizontal me nr. Prok. 615-18-5164-5-2-1	03.10.2018	11.11.2018	26 035.00	K.K.Podujev	prokurim@ksh.gov.net	0302041022
6	Zgjerimi i rrugës M2 segmenti hyrja në qytet të Piskovës Lot 2 me nr.pro M16-545-511	21.07.2020	30.09.2020	78 592.00	Beni Com	beni@beni.com	04176808
7	Sinjalizim Horizontal dhe Vertikal me nr. Prok. 635-19-2706-2-2-1	06-09-2019	12.07.2021	59 112.62	K.K. Pejë	prokurim@ksh.gov.net	0302043436
8	Rregullimi dhe mëmbajtja e sinjalizimit vertikal dhe horizontal në Komunën e Kaçanikut	21-11-2019	03.08.2021	85 534.00	K.K.Kaçanik	prokurim@ksh.gov.net	382 388 438 922

Lindi Markings sh.p.k
Drejtor
Faton Gjokaj



Së këndejmi sipas RRUOPP kemi rastin e njëjtë sikur rasti i juaj që nuk e keni dëshmuar me listën e punëve të kryera se ju e dëshmoni sipas kërkesës 3 neni 9.1 dhe 9.2, ky udhëzim na obligon të refuzojmë tenderin pa kërkuar informacione të mëtejshme.

Shembujt e mëposhtëm nuk janë të vetmet raste. Varësisht nga rasti i paraqitur AK duhet të veproj në përputhje me nenin 72 dhe nenin 59 të LPP-se

Problemi	Si të veprohet?	Neni i LPP-se
Lista e kontratave të realizuara e dorëzuar nuk përmbush kërkesat minimale të vlerës se përcaktuar	Refuzo tenderin pa kërkuar informacion të mëtejshëm	69

Andaj pretendimi juaj në këtë pikë është i pabazuara.

PRETENDIMI ANKIMOR Nr. 2:

Në arsye tjetër tuajën për eliminimin tonë e keni cekur se:

Në ofertën e juaj të dorëzuar Mungojnë Kodet e produkteve në Katalog;

Po ashtu mungojnë dhe produktet e kërkuara në ofertë dhe Katalogu është i panënshkruar dhe i pavulosur nga personi i autorizuar i Kompanisë, andaj oferta juaj konsiderohet e papërgjegjshme konform LPP-së

Arsyeja juaj e lartcekur për eliminimin tonë nga ky aktivitet i prokurimit është e pa bazuar dhe e paqëndrueshme dhe njëkohësisht e njëjta arsye bie në kundërshtim me Udhëzimin Administrativ MI Nr.09/2017 për Sinjalizim dhe Rregullat e Trafikut Rrugor, e i cili UA i ka përcaktuar qartë kodet dhe shifrat për produktet e sinjalizimit, andaj ne si OE dhe asnjë OE tjetër nuk ka të drejtë të vendos kode dhe shifra sipas dëshirës së tyre në katalog, pasi që siç e cekëm kodet dhe shifrat e produkteve janë të rregulluara me udhëzuesin e lartcekur i cili është i nënshkruar nga Ministri i Infrastrukturës z. Lutfi Zharku me dt.20.06.2017. **(Bashkangjitur keni UA MI Nr.09/2017).**

Ndërsa sa i përket arsyes tuaj se ne e kemi prezantuar katalogun e pa nënshkruar dhe ë pa vulosur, ju sqarojmë se ky është vetëm një lëshim teknik nga ana jonë ku gjatë ofertimit e kemi bashkangjitur katalogun e pa nënshkruar dhe të pa vulosur në vend të atij të vulosur dhe të nënshkruar. Pra ne e posedojmë katalogun e nënshkruar dhe të vulosur, mirëpo që për shkak të një lëshimi teknik i njëjti nuk është bashkangjitur ne ofertë.

Mirëponë lidhje me mos nënshkrimin dhe vulosjen e katalogut dhe nëse ju si AK keni pasur ndonjë dilemë tjetër lidhje me katalogun e prezantuar nga ana jonë, atëherë shumë lehtë keni mundur të kërkonit sqarime shtesë konform dispozitave të nenit 59.2 dhe 72 të LPP-së dhe ne do të ju kishim qartësuar të gjitha dilemat tuaja, mirëpo një veprim të tillë nuk e keni bërë, mirëpo jeni munduar që me çdo kusht të na eliminoni neve si OE i përgjegjshëm dhe njëkohësisht më i lirë në këtë aktivitet të prokurimit.

PËRGJIGJE PËR PRETENDIMI ANKIMOR Nr. 2:

Ju sqarojmë se ky pretendim i juaj është i pabazuar, pasi që ju keni dorëzuar një album me fotografi gjatë kryerjes së punëve nëpër terren të pa nënshkruar dhe të pa vulosur dhe po e quani katalog, ndërsa ne kemi kërkuar si vijon:

Kërkesa 5

a Katalogu i produkteve të kompanisë me kod dhe shifër për secilin produkt.

b Dëshmi apo kontrate për prodhimin apo furnizimin me gypa te zinguar, ngjyre për aplikim ne rruge.

c Një plan për menaxhimin te trafikut.

Dëshmia 5

a Një kopje e katalogut i nënshkruar dhe vulosur nga personi i autorizuar i Kompanisë

b Dëshmi apo kontrate për prodhimin apo furnizimin me gypa te zinguar, ngjyre për aplikim ne rruge.

c Të prezantohet plani për menaxhim te trafikut i nënshkruar nga Inxhinieri ose Bachelor i Komunika cionit dhe për pilohet për rastin specifik- qyteti i Rahovecit.

Ndërsa sa i përket çështjes se UA09/2017 i Ministrisë së Infrastrukturës, ne nuk kemi kërkuar të bashkëngjitet udhëzimi por katalogu i kompanisë i nënshkruar dhe i vulosur për arsye se gjate porosive te ndryshme Menaxheri i kontratës porosinë e bene ne baze te kodeve-numrave apo shifrave tjera ne katalogun e OE qe do te lidhe kontratë me AK: Komuna e Rahovecit.

Andaj pretendimi juaj në këtë pikë është i pabazuara.

PRETENDIMI ANKIMOR Nr. 3:

Ndërsa sa i përket arsyes tuaj të fundit për eliminimin tonë nga ky aktivitet i prokurimit, ku e keni cekur se kinse “Plani i menaxhimit të trafikut nuk ka të bëjë me rastin specifik –qyteti i Rahovecit”, ju sqarojmë se edhe ky arsyetim i juaji për eliminimin tonë është vetëm një pretekst për të na eliminuar neve si OE i përgjegjshëm dhe më i lirë në këtë aktivitet të prokurimit.

Ne në ofertë e kemi prezantuar planin e menaxhimit të trafikut për aktivitetin e prokurimit “SINJALIZIMI HORIZONTAL DHE VERTIKAL I RRUGËVE” në KK Rahovec, mirëpo për ne është e çuditshme se si ka mundësi që ju si AK na eliminoni se kinse ky plan i prezantuar nga ne nuk ka të bëjë me qytetin e Rahovecit, përderisa ne kemi ofertuar në këtë aktivitet të prokurimit i iniciuar nga vet KK Rahovec, ku edhe tek titulli i planit të menaxhimit të trafikut shkruan se Sinjalizimi do të bëhet në komunën e Rahovecit.
Ky arsyetim i juaji edhe një herë po e dëshmon qartë diskriminimin që po na bëni ju si AK neve si OE i përgjegjshëm dhe më i lirë në këtë aktivitet të prokurimit.

PËRGJIGJE PËR PRETENDIMI ANKIMOR Nr. 3:

Ju sqarojmë se ky pretendim i juaj është i pabazuar:

Sa i përket kësaj pike, nga kërkesa 5c është kërkuar dëshmia 5c ku ne mënyre specifike kemi kërkuar qe **Të prezantohet plani për menaxhim te trafikut i nënshkruar nga Inxhinieri ose Bachelor i Komunikacionit dhe përpilohet për rastin specifik-qyteti i Rahovecit.** Pra ju e keni dorëzuar një plan te menaxhimit te trafikut por që nuk ka të bëjë me rastin specific Komuna e Rahovecit, dhe si I tille nuk e plotëson ketë kërkesë te dosjes se tenderit.

<p>Kërkesa 5</p> <p>a Katalogu i produkteve të kompanisë me kod dhe shifër për secilin produkt.</p> <p>b Dëshmi apo kontrate për prodhimin apo furnizimin me gypa te zinguar, ngjyre për aplikim ne rruge.</p> <p>c Një plan për menaxhimin te trafikut.</p>	<p>Dëshmia 5</p> <p>a Një kopje e katalogut i nënshkruar dhe vulosur nga personi i autorizuar i Kompanisë</p> <p>b Dëshmi apo kontrate për prodhimin apo furnizimin me gypa te zinguar, ngjyre për aplikim ne rruge.</p> <p>c Të prezantohet plani për menaxhim te trafikut i nënshkruar nga Inxhinieri ose Bachelor i Komunikacionit dhe përpilohet për rastin specifik-qyteti i Rahovecit.</p>
--	--








Andaj pretendimi juaj në këtë pikë është i pabazuara.

PRETENDIMI ANKIMOR Nr. 4:

Gjithashtu ju keni rekomanduar për kontratë një OE i cili nuk i përmbush të gjitha kërkesat e dosjes së tenderit dhe të njoftimit për kontratë.

OE i rekomanduar për kontratë është i papërgjegjshëm për faktin se i njëjti nuk i ka plotësuar të gjitha kërkesat e dosjes së tenderit përkatësisht kërkesat mbi mundësitë teknike dhe profesionale në lidhje me stafin e kërkuar. Tek dosja e tenderit është kërkuar që OE ofertues ti posedojnë 8 punëtorë gjithsej duke përfshirë edhe stafin profesional, ndërsa OE i rekomanduar për kontratë i ka prezantuar gjithsej 7 punëtorë në listën e stafit.

I njëjti tek lista e stafit është munduar të manipulojë me listën e stafit ku tek numrat e listës mungon numri katër, ku është shumë i çuditshëm fakti se si ju si AK nuk e keni vërejtur me apo pa qëllim një fakt të tillë. Nga fotoja e mëposhtme vërehet qartë fakti se si OE i rekomanduar për kontratë është munduar të manipulojë me listën e stafit:

Lista e Stafit						
Nr	Emri	Mbiemri	Data lindjes	Ekspierenca	Profesioni	
1	KORAJ	ELSHANI	16.02.1987	10	Inzhiner i komunikacionit	
2	SELMAN	KOLGECI	25.11.1968	12	Inzhiner i komunikacionit	
3	FETJE	KUÇ - KHASNIQI	06.07.1989	3	Inzhiner i komunikacionit	
4	LUEZIM	KOLGECI	22.04.1997	5	Makinist për shenjëzime horizontale	
5	GAZMEND	KOLGECI	10.04.1993	5	Makinist/ Punëtorë	
6	ELEZ	KADIRJAJ	23.09.2002	3	Punëtorë	
7	EGZON	SHALLA	16.11.1992	3	Punëtorë	

Ju si AK siç duket nuk i keni analizuar në tërësi dokumentet e prezantuar nga OE i rekomanduar për kontratë, mirëpo qëllimi i juaj i vetëm ka qenë eliminimi ynë nga ky aktivitet i prokurimit, ndërsa nga veprimet tuaja shihet qartë se në këtë aktivitet të prokurimit e keni favorizuar haptas OE të rekomanduar për kontratë.

PËRGJIGJE PËR PRETENDIMI ANKIMOR Nr. 4:

Ju sqarojmë se ky pretendim i juaj është i pabazuar, pasi që Operatori Ekonomik i rekomanduar për kontratë, ka prezantuar listën e punëtorëve/stafit teknik, në të cilat janë te prezantuar stafi i përhershëm, stafi menaxherial dhe të punëtorëve prej: **Shtatë (7) punëtor të nënshkruar dhe te vulosur nga Operatori Ekonomik**, ne pajtim me Kërkesën 1 / Dëshminë 1, të Kapacitetit teknik dhe profesional sipas FDT-së

Për këtë çështje ka vendim edhe nga Organi Shqyrtues i Prokurimit, si për shembull vendimi nr. 710/19.

Andaj pretendimi juaj në këtë pikë është i pabazuar.

PRETENDIMI ANKIMOR Nr. 5:

OE i rekomanduar për kontratë është i papërgjegjshëm edhe për faktin se i njëjti nuk e plotëson edhe kërkesën tjetër të dosjes së tenderit ku kërkesë ka qenë *“Katalogu i produkteve të kompanisë me kod dhe shifër për secilin produkt”*, ndërsa si dëshmi dokumentare është kërkuar *“Një kopje e katalogut i nënshkruar dhe vulosur nga personi i autorizuar i Kompanisë”*.

OE i rekomanduar për kontratë nuk e plotëson kërkesën e lartcekur për faktin se i njëjti ka prezantuar kode në katalog të cilat nuk janë në përputhje me Udhëzimin Administrativ MI Nr.09/2017 për Sinjalizim dhe Rregullat e Trafikut Rrugor. Në udhëzimin e lartcekur ashtu siç e kemi cekur edhe më lartë janë të përcaktuara qartë kodet dhe shifrat për produktet e sinjalizimit dhe asnjë OE nuk mund dhe nuk duhet të vendos kode tjera, pasi që në këtë rast udhëzimi i lartcekur është ligj për OE dhe i njëjti duhet të respektohet, mirëpo që në këtë rast ju si AK nuk e keni respektuar pasi që keni rekomanduar për kontratë një OE i cili ka prezantuar në ofertën e tij kode të cilat nuk janë në përputhje me udhëzimin e lartcekur.

Andaj duke u bazuar në sqarimet e lartcekura shihet qartë se ju si AK keni rekomanduar për kontratë një OE i cili është i papërgjegjshëm dhe si i tillë është dashur të konsiderohet edhe nga ana juaj, mirëpo që një veprim të tillë nuk e keni bërë duke e favorizuar haptas OE të rekomanduar për kontratë dhe duke na diskriminuar neve si OE i përgjegjshëm dhe njëkohësisht me çmim më të lirë në këtë aktivitet të prokurimit.

PËRGJIGJE PËR PRETENDIMI ANKIMOR Nr. 5:

Ju sqarojmë se ky pretendim i juaj është i pabazuar, për pikë që ju pretendoni që OE i rekomanduar për kontratë ka dorëzuar katalog me kode të cilat nuk janë sipas udhëzimit administrative ju sqarojmë se:

- Ne nuk kemi kërkuar që katalogu i Operatoreve Ekonomik të jetë i njëjti me udhëzimin e Ministrisë së Infrastrukturës sepse siç e cekem me lartë duhet të prezantohet katalogu i kompanisë i nënshkruar dhe i vulosur për arsye se gjatë porosive të ndryshme Menaxheri i kontratës porosinë e bene në baze të kodeve-numrave apo shifrave tjera në katalogun e OE që do të lidhe kontratë me AK: Komuna e Rahovecit.

Andaj pretendimi juaj në këtë pikë është i pabazuar.

Nga konstatimet e lartëcekur u vendos si në dispozitave të këtij Vendimi.

Kjo procedurë është trajtuar konform Ligjit Nr. 04/042, Ligji për Prokurimin Publik ne Republikën e Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-92.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij **vendimi të AK-së ju munde të paraqitni** ankesë pranë OSHP-së në pajtim me nenin 109 të LPP-së. Ankesa pranë OSHP-së duhet të dorëzohet brenda 10 (dhjetë) ditëve pas vendimit të lëshuar nga Autoriteti Kontraktues.

Vendimi Publikohet:

Në platformën elektronike në adresën: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>

Astrit Mullabazi
Menaxher i Zyrës se Prokurimit
Komuna e Rahovecit